



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIM TË POLITIKAVE

## Sfida RTK

Prishtinë, dhjetor 2011

E drejta autoriale © 2011 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	4
Metodologjia.....	5
Analiza .....	5
Konkluzione dhe rekomandime .....	7

## Hyrje

Lajmet e orës 19:30 në Radio-Televizionin e Kosovës (RTK) mbesin burimi kryesor i informimit për shumicën e qytetarëve të Kosovës. Informatat e plasuara në këtë edicion të lajmeve janë profilizuesi kryesor i opinionit publik. Prandaj, është qenësore që në këtë edicion të lajmeve të zbatohen standardet më të larta profesionale, ashtu që informimi të jetë sa më i drejtë e sa më i saktë që qytetarët e Kosovës të jenë të mirinformuar. Informimi i mirë i qytetarëve do të sigurojë se debati do të jetë shumë më i informuar ashtu që këta të jenë në gjendje të qenë bindje e qëndrime sa më të informuara për të gjitha zhvillimet në Kosovë.

Pavarësia e RTK-së, e me këtë edhe liria e punës së gazetarëve dhe redaktorëve që përgatisin lajmet në RTK, garantohet me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës<sup>1</sup> dhe – siç ka thënë KIPRED edhe në raportet e mëhershme – ruajtja e pavarësisë financiare, menaxheriale dhe editoriale të RTK-së, mbetet një obligim i gjithë shoqërisë Kosovare.

Për shkak të fuqisë që kanë lajmet qendrore të RTK-së, ky emision është edhe cak kryesor i politikanëve dhe partive politike. Prezantimi në këtë emision sjell vizibilitet e rrjedhimisht edhe fuqi për politikanët. Për fat të keq, siç është dokumentuar disa herë, klasa politike kosovare mundohet që të ndikojë drejtpërdrejt në përmbajtjen e lajmeve në RTK duke u lidhur apo duke u bërë presion stafit që përgatitë apo mbikëqyr lajmet në këtë institucion të rëndësishëm publik. Ndërhyrjet e tilla janë vërejtur nga Komisioni Evropian, që i kritikon këto ndërhyrje në Raportin e Progresit së paku që nga viti 2009, por edhe nga EBU që në një letër të vitit 2009 akuzon qeverinë e udhëhequr nga PDK-ja për ndërhyrje në punën e RTK-së.<sup>2</sup>

KIPRED, me dëshirë që të analizojë emisionin e lajmeve qendrore të RTK-së, ato të orës 19:30, ka bërë monitorimin e këtij emisioni për një periudhë katër mujore. Gjatë kësaj kohe janë përcjellë lajmet e dhëna, renditja që u është bërë lajmeve si dhe cilësia e tyre. Synimi këtij ushtrimi ka qenë që të matet niveli i profesionalizmit në këtë emision informativ dhe të vlerësohet se sa gazetarët dhe redaktorët e lajmeve në RTK e ruajnë integritetin profesional dhe u përmbahen parimeve dhe standardeve profesionale.

RTK ka kodin e vet të mirësjelljes, “Standardet profesionale”, me të cilin kod janë të njoftuar të gjithë gazetarët dhe redaktorët e RTK-së. Dokumenti “Standardet profesionale” të RTK-së, që është miratuar nga Bordi i RTK-së në vitin 2005, paraqet një kornizë të mirë për të siguruar raportim profesional të RTK-së. Dokumenti gjithashtu vëren rëndësinë e RTK-së dhe lajmeve e raportimeve të RTK-së. Nga kjo mund të konkludojmë se gazetarët e RTK-së janë të vetëdijshëm për rëndësinë e punës së tyre për shoqërinë dhe për përgjegjësinë që kanë në punë. Ky raport do të vlerësojë edhe se sa respektohet ky kod në punën e përditshme të gazetarëve të RTK-së, për të bërë më bindëse analizat që do të prezantohen këtu.

<sup>1</sup> Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, neni 1 dhe 6

<sup>2</sup>Shih në: [http://www.ebu.ch/en/union/news/2009/tcm\\_6-66520.php](http://www.ebu.ch/en/union/news/2009/tcm_6-66520.php) (hapur për herë të fundit më 28 dhjetor 2011).

## **Metodologjia**

Në kuadër të hulumtimit është monitoruar programi i lajmeve qendrore të RTK-së për katër muaj, prej muajit gusht deri në muajin nëntor të vitit 2011. Në kuadër të monitorimit janë përcjellë renditja e lajmeve, sa i është dhënë hapësirë pushtetit e sa opozitës si dhe sa u është dhënë hapësirë temave tjera. Por, vëmendje i është kushtuar edhe përmbajtjes së vet raportit gazetaresk, pra, është analizuar raportimi për t'u parë se sa është profesional.

Një nga vështirësitë kryesore gjatë studimit të bërë kanë qenë zhvillimet objektive jashtë domenit të gazetarisë, më saktësishteskalimi i gjendjes në pjesën veriore të Kosovës. Kjo ka bërë që lajmet në periudhën e monitoruar shpesh të dominohen nga zhvillimet në këtë pjesë të Kosovës dhe t'i lihet shumë pak hapësirë zhvillimeve politike apo zhvillimeve tjera. Megjithatë, kjo nuk ka bërë të pamundur që të identifikohen disa tendenca të përgjithshme që vërehen në RTK e që do të prezantohen në këtë punim.

“Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës” është dokument publik dhe mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e RTK-së<sup>3</sup>. Ky dokument përcakton parimet që duhet të garantojnë profesionalizmin e gazetarëve dhe redaktorëve të RTK-së. Ky dokument është përpiluar dhe miratuar në vitin 2005 dhe ndonëse është hap i rëndësishëm i RTK-së drejt përcaktimit të standardeve profesionale, duket si një punë e papërfunduar pasi dokumenti kërkon elaborim më të qartë të parimeve etike e profesionale për ta bërë edhe më të dobishëm atë.

Ky raport është bazuar në monitorim të drejtpërdrejtë të programit informativ të kanalit të vetëm televiziv të Radiotelevizionit të Kosovës. Monitorimi dhe përpilimi i këtij raporti janë kryer në mënyrë të pavarur dhe gjatë përpilimit nuk janë konsultuar as intervistuar përfaqësuesit e RTK-së, bordit të RTK-së apo ndonjë pale tjetër.

## **Analiza**

Edicioni qendror i lajmeve në RTK, që transmetohet prej orës 19:30 sipas shumicës së anketimeve të bëra deri më tani është edicioni më i shikuar informativ në Kosovë me një shikueshmëri prej më shumë se 500,000 telespektatorësh, gjë që e bën këtë edicion të lajmeve emisionin më të rëndësishëm dhe më me ndikim në Kosovë në kategorinë e programeve informative. Arsyet e këtij popullariteti të këtij emisioni të lajmeve janë së paku dy. I pari mund të jetë ai i inercionit pasi lajmet e shfaqura në po të njëjtën orë, në 19:30, kanë qenë lajmet kryesore të vetme në gjuhën shqipe në Kosovë e më gjerë, që janë shfaqur në Radio Televizionin e Prishtinës, që më nuk ekziston. Shprehia e lajmeve të orës shtatë e gjysmë mund të jetë një

---

<sup>3</sup>“Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës”, shkarkuar nga faqja zyrtare e RTK-së në adresën [http://rtklive.com/rtk/standardetprofesionale\\_sq.pdf](http://rtklive.com/rtk/standardetprofesionale_sq.pdf). Shkarkimi i fundit më 25 dhjetor 2011.

faktor i rëndësishëm që ka mbajtur lartë shikueshmërinë e lajmeve kryesore të RTK-së. Arsyeja e dytë mund të jetë ajo që RTK-ja mbetet mediumi i vetëm publik, pra jo privat, e rrjedhimisht edhe më i pavarur në sytë e qytetarëve të Kosovës. Dy kanalet tjera në Kosovë që kanë licencë për transmetim në tërë territorin e Kosovës, kanale kombëtare, janë KTV dhe RTV21 që janë kanale private.

Hulumtimi i fundit i KIPRED vëren se përkundër vërejtjeve të shpeshta që i bëhen emisionit të lajmeve të RTK-së, pak është bërë që të përmirësohet kualiteti i raportimit. Më saktësisht, lajmet e RTK-së vazhdojnë të jenë në pjesën më të madhe “lajme të protokollit”, pra lajme që përcjellin se çfarë kanë bërë kryesisht udhëheqësit politikë të vendit. Lajmet e RTK-së merren shumë më pak me temat e tjera. Duket se vetëm në fundjava, kur ka pak zhvillime politike, gazetarët e RTK-së prekin edhe tema tjera që nuk janë politike. Siç ka shkruar edhe më herët KIPRED, në raportin “Monitorimi i programit informativ të Radiotelevizionit të Kosovës”, i botuar në janar të vitit 2011I, “lajmet qendrore në RTK i ngjasojnë më shumë një zëdhënësi të qeverisë, opozitës e deri diku edhe të shoqërisë civile, i cili veçse përçon te publiku atë që këto tri dikastere e thonë”<sup>4</sup>.

Monitorimi i fundit i bërë nga KIPRED vëren se nuk ka përmirësim as në proporcionin e lajmeve që jepen në programin qendror informativ. Ndonëse rregullorja e RTK-së parasheh se duhet siguruar ekuilibri i duhur midis lajmeve vendore, rajonale e ndërkombëtare, pa sqaruar se çfarë duhet të jetë ky proporcion, nga monitorimi vëren se përqindja e lajmeve nga rajoni dhe atyre ndërkombëtare është minimal. Vërehet gjithashtu që nuk është përmirësuar cilësia e raportimit të ngjarjeve nga rajoni e bota. KIPRED ka përmendur këto mangësi edhe në raportin e sipërpërmendur. Zhvillimet në Kosovë ndikohen nga zhvillimet në rajon dhe në botë prandaj edhe raportimet për këto zhvillimet duhet të gjejnë vend në lajmet qendrore të RTK-së. Me injorimin e lajmeve ndërkombëtare krijohet përshtypja se Kosova është e ndarë nga bota, e izoluar dhe e shkëputur, pa u ndikuar dhe pa ndikuar jashtë kufijve të saj.

Monitorimi i fundit ka konfirmuar gjetjet e mëparshme të KIPRED se raportimi në lajmet qendrore në RTK është i balancuar nëse shikohet se a mbulohen të gjithë aktorët politikë. Lajmet e orës 19:30 raportojnë për aktivitetet kryesore edhe të Kuvendit të Kosovës, edhe të Qeverisë së Kosovës, edhe Zyrës së Presidentit por edhe opozitës dhe shoqërisë civile. Hapësira që i jepet secilit aktor në lajme zakonisht është në përpjesëtim të drejtë me angazhimet e tyre. Pra, sa herë një parti opozitare ka ndonjë aktivitet apo thjeshtë jep një prononcim për ndonjë zhvillim në Kosovë, RTK do ta raportojë atë. Është ky një balancim shumë i thjeshtësuar që zbaton RTK, pra jep lajme për qeverinë e pastaj edhe lajme për opozitën apo ndonjë kritikues të qeverisë. Në të vërtetë, ky nuk është detyrimisht balancimi që kërkohet edhe nga vet kodi i RTK-së. Kodi kërkon që balancimi të bëhet në vet raportimet, pra që asnjë raportim, asnjë lajm, të mos jetë i

---

<sup>4</sup>Raporti gjendet në faqen e KIPRED në:

[http://kipred.net/web/upload/monitorimi\\_i\\_programit\\_informativ\\_RTK.pdf](http://kipred.net/web/upload/monitorimi_i_programit_informativ_RTK.pdf)

njëanshëm, por t'i paraqesë në mënyrë të barabartë të gjitha palët që janë të përfshira në një problem që e trajton raporti gazetaresk.

Për më tepër, vërehet se lajmet zakonisht nuk kanë nevojë për balancim pasi nuk merren me ndonjë problem por janë vetëm raporte që informojnë për një ngjarje apo aktivitet dhe nuk kërkojnë balancim të pikëpamjeve e burimeve. Një konkludim të njëjtë ka nxjerrë edhe raporti i KIPRED i botuar në janar të vitit 2011 e që ka monitoruar dhe vlerësuar lajmet kryesore të RTK-së.

Në anën tjetër, në ato pak raportime për ndonjë problem e në të cilin kërkohen të ballafaqohen së paku dy burime me pikëpamje të ndryshme, gazetarët e RTK-së përpiqen të bëjnë këtë balancim. Mirëpo, edhe këtu vërehen lëshime kur gazetarët nuk arrijnë të gjejnë njërën palë dhe mjaftohen me arsyetimin se pala në fjalë nuk kishte qasje apo ngjashëm. Kjo është mangësi që vërehet edhe në “Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës” pasi aty nuk elaborohen qartë hapat që duhet marrë një gazetar për t’u konsideruar se i ka shterë të gjitha mundësitë për të gjetur informacionin e nevojshëm për të qenë i balancuar.

Një praktikë tjetër që vërehet është ajo e raporteve të gjata që shpesh zgjasin edhe më shumë se 4 minuta. RTK është shtëpia mediale më e madhe në Kosovë me më shumë gazetarë se të gjitha shtëpitë tjera mediale e me kushte teknike më të mira. Prandaj, gazetarët e RTK-së kanë mundësi që të përgatisin më shumë lajme brenda një dite. Me lajme më të shkurta, jo më të gjata se 2 minuta, RTK do të siguronte që do të raportohen më shumë ngjarje të rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Me pikëpyetje mbetet edhe renditja e lajmeve në RTK. Shembull më përshkrues është ai i lajmit të parë të dhënë në lajmet qendrore të datës 7 nëntor 2011 për një “shkollë futbollit” me emrin “Arsenal”. Duket se gazetari “ka nuhatur” një mashtrim në këtë shkollë futbollit që po shfrytëzonte emrin e një klubi futbollistik me famë pa pasur lidhje me të. Mund të supozojmë që qëllimi i gazetarëve dhe redaktorëve ka qenë i mirë, që të tërheqin vërejtjen nga një mashtrim i mundshëm. Megjithatë, raporti gazetaresk nuk vërteton ndonjë keq-bërje përveç përdorimit të emrit “Arsenal” pa pasur lidhje me ekipin e futbollit. Raportimi nuk ka qenë mjaft bindës që të arsyetojë shfaqjen e tij si lajmi i parë në edicionin qendror të lajmeve.

### **Konkluzione dhe rekomandime**

Monitorimi i fundit i emisionit të lajmeve të orës 19:30 në RTK ka zbuluar se shumica e vërejtjeve të dhëna nga KIPRED në raportin e janarit 2011 qëndrojnë ende. Lajmet e RTK-së mbesin burim informacioni për shumicën dërmuese të qytetarëve të Kosovës e rrjedhimisht edhe kërkojnë përgjegjësi dhe profesionalizëm në përgatitjen e tyre. Gazetarët e RTK-së në përgjithësi mbesin të kujdesshëm në raportimet e tyre. Për fat të keq, kujdesi që të përfaqësojnë të gjithë aktorët në skenën tonë politike po kthehet në një vet-censurë për RTK-në.

Gazetarët nuk po hyjnë në tema më të rënda e më hulumtuese por po mjaftohen me raportime protokolare. Duhet të jetë synim i gazetarëve por edhe redaktorëve të RTK-së që të shtojnë raportimin për tema që janë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës e që janë përtej zhvillimeve politike ditore. Një shembull i tillë është vërejtur nga KIPRED pas përfundimit të monitorimit të lajmeve të orës 19:30. Një raport hulumtues për shpërndarjen e bukës nëpër shitore ka sjellë një ndryshim pozitiv. Raporti gazetaresk njoftonte se shpërndarësit e bukës që e bëjnë shpërndarjen në orët e hershme të mëngjesit, shpesh i vendosin pakot me bukët para dyerve të shitoreve që ende nuk janë hapur, duke i lënë bukët t'i ekspozohen ndotjes nga pluhuri që vjen nga makinat apo edhe nga kafshët. Raporti gazetaresk ka nxitur inspektorët gjegjës, që herën e parë ishin arsyetuar se nuk mund të bëjnë asgjë për këtë çështje pasi nuk janë në punë aq herët në mëngjes sa të evidentojnë këto shkelje, që tani të dilnin në terren dhe të shpërndanin gjoba për ata shpërndarës të bukës që e lënë atë në kushte johigjienike para shitoreve. KIPRED, duke e përgëzuar RTK-në për këtë, e inkurajon atë që të bëjë më tepër raporte të tilla që janë me interes për qytetarin e Kosovës.

Një zhvillim tjetër pozitiv në raportimet në RTK është vërejtur në përgjithësi në raportimet për zhvillimet në veritë Kosovës. Deri sa në mars të vitit 2004 raportimet e gazetarëve, përfshirë edhe ata të RTK-së, ishin një nga shkaktarët që i dhanë zjarr trazirave, në verën e vitit 2011 gazetarët e RTK-së raportnin në mënyrë të matur për zhvillimet në veri të Kosovës. Raportet nuk kishin gjuhë luftë-nxitëse. Raportimi i RTK-së për zhvillimet në veri kishte mangësitë që kishin edhe raportimet e mediave tjera e kjo ishte pamundësia që të shkonin në vendin e ngjarjes e të raportnin se çfarë po ndodhte në veri. Kjo i ka bërë të gjitha mediat, pra edhe RTK-në, që të varen shumë në burimet zyrtare, në këtë rast Policinë e Kosovës dhe Qeverinë e Kosovës, për të raportuar për zhvillimet në dhe rreth pjesës veriore të Kosovës. RTK ka edhe gazetarë serbë që punojnë për redaksinë e lajmeve në gjuhën serbe pormund të supozohet se edhe këta kanë qenë të penguar që të shkojnë në pjesën veriore të Kosovës për të raportuar drejtpërdrejt për zhvillimet atje.<sup>5</sup> Megjithatë, mund të konkludojmë se raportimet për zhvillimet në veri, ndonëse të liruara nga gjuha e luftë-nxitëse, megjithatë nuk arrinin të përfaqësonin plotësisht dhe në mënyrë krejtësisht të pavarur zhvillimet e ditës në këtë pjesë të Kosovës.

RTK-ja pa dyshim ka përparuar edhe brenda këtij viti gjatë të cilit është monitoruar nga KIPRED. Disa nga të arriturat u përmendën më lartë. Megjithatë, kjo nuk mjafton për të thënë se qytetarëve të Kosovës u garantohet raportim përgjithësisht profesional dhe i paanshëm. Mbetet imperativ për RTK-në që të punojë të plotësojë më tutje kodin e gazetarëve dhe ta implementojë atë në mënyrë të përpiktë.

---

<sup>5</sup>Kanali televiziv "Klan Kosova" ka qenë mediumi i vetëm që ka pasur një gazetar, serb i Kosovës, që ka raportuar drejtpërdrejt nga veriu. Megjithatë, edhe ai që sulmuar dhe rrahur nga ekstremistë në veri të Kosovës dhe që penguar që të vazhdojë punën e tij. E njëjta ka mundur të ndodhë edhe me gazetarët e nacionalitetit serb që punojnë në RTK.



Në bazë të këtyre observimeve më sipër, mund të japim edhe rekomandime për të realizuar synimin e deklaruar të RTK-së, profesionalizmin në punë.

- RTK të plotësojë “Standardet e Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programin e Radiotelevizionit të Kosovës” për të larguar mundësitë për lëshime në punë dhe për të ngritur standardet e profesionalizmit. Të sqarohet, për shembull, se kur mund të thuhet se janë shteruar të gjitha mundësitë për të kontaktuar një protagonist të një lajmi apo për të gjetur një burim, a mjafton përpjekja për të marrë një protagonist në telefon apo duhet që të shkohet më tutje duke provuar të kontaktohet edhe fizikisht protagonistin.
- Duke shkurtuar minutat për një raport – edhe ashtu lajmet që zgjasin mbi 4 minuta rrezikojnë të bëhen të mërzitshme për shikuesit – RTK do të krijojë hapësirë për më tepër raporte në kuadër të 30 minutave të ndarë për lajmet qendrore të orës 19:30.
- RTK të sigurojë që raportet që merrenme çështje apo probleme të cilat kanë një rëndësi më të madhe sesa përcimi i thjeshtë i ngjarjeve të ditës të gjejë më shumë vend të programin e lajmeve qendrore. Storjet protokollare të cilat merren me takime por që në vete nuk trajtojnë ndonjë çështje mund të mënjanohen.
- Të shtohen raportet hulumtuese dhe të shfrytëzohet pozicioni i fuqishëm që ka RTK-ja për të nxitur ndryshime pozitive në shoqëri. Edhe me ato pak raporte hulumtuese që ka bërë RTK-ja, ka dëshmuar se mund të ketë impakt në shoqëri. Inkurajohen gazetarët dhe redaktorët që këtë ta bëjnë edhe më shumë.
- Me qëllim që të mbajë një nivel të lartë të profesionalizmit, RTK inkurajohet që të bëjë vet një monitorim të vazhdueshëm të lajmeve qendrore. Vet-kritika dhe zhvillimi i përhershëm duhet të zëvendësojnë vet-censurën. Kjo do të ngrëjë kredibilitetin e RTK-së në sytë e shikuesve të vet.